



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

Raporti i monitorimit të II-të, përfundimtar i
Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar
për vitin 2023

Dhjetor, 2025

Tabela e përmbajtjes

HYRJE.....	5
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	6
Koordinimi dhe monitorimi i projekteve.....	6
RAPORTI PËRMBLEDHËS	8
Raporti përmbledhës për rajonin zhvillimor Qendër	14
Raporti përmbledhës për rajonin zhvillimor Veri.....	15
Raporti përmbledhës për rajonin zhvillimor Perëndim	16
Raporti përmbledhës për rajonin zhvillimor Jug	17
Raporti përmbledhës për rajonin zhvillimor Lindje	18
Përfundimi	20

Lista e tabelave


Tabela 1: Zyrtarët monitorues në rajonet zhvillimore dhe numri i monitorimeve të realizuara	7
Tabela 2: Bizneset Start Up të cilat nuk janë funksionale (sipas rajoneve zhvillimore)	8
Tabela 3: Pasqyra e përgjithshme e financimit të PZHRB 2023 sipas rajoneve zhvillimore dhe ndryshimet në punësim 2023-2025.....	9
Tabela 4: Pasqyra e financimit të kategorisë Start UP në PZHRB 2023 sipas rajoneve zhvillimore dhe ndryshimet në punësim 2023-2025.....	11
Tabela 5: Pasqyra e financimit të kategorisë Lot 1 në PZHRB 2023 sipas rajoneve zhvillimore dhe ndryshimet në punësim 2023-2025.....	12
Tabela 6: Pasqyra e financimit të kategorisë Lot 2 në PZHRB 2023 sipas rajoneve zhvillimore dhe ndryshimet në punësim 2023-2025.....	13
Tabela 7: Pasqyra e përgjithshme e financimit të PZHRB 2023 sipas rajonit zhvillimore Qendër dhe ndryshimet në punësim 2023-2025.....	14
Tabela 8: Pasqyra e përgjithshme e financimit të PZHRB 2023 sipas rajonit zhvillimore Veri dhe ndryshimet në punësim 2023-2025.....	15
Tabela 9: Pasqyra e përgjithshme e financimit të PZHRB 2023 sipas rajonit zhvillimore Perëndim dhe ndryshimet në punësim 2023-2025.....	17
Tabela 10: Pasqyra e përgjithshme e financimit të PZHRB 2023 sipas rajonit zhvillimore Jug dhe ndryshimet në punësim 2023-2025.....	18
Tabela 11: Pasqyra e përgjithshme e financimit të PZHRB 2023 sipas rajonit zhvillimore Lindje dhe ndryshimet në punësim 2023-2025.....	19

Lista e figurave

Figura 1: Kontributi financiar i MZHR-së dhe ndikimi në punësim sipas rajoneve zhvillimore (2023-2025)	10
Figura 2: Kontributi financiar i MZHR-së dhe ndikimi në punësim (2023-2025) në rajonin zhvillimor Qendër.....	15
Figura 3: Kontributi financiar i MZHR-së dhe ndikimi në punësim (2023-2025) në rajonin zhvillimor Veriu.....	16
Figura 4: Kontributi financiar i MZHR-së dhe ndikimi në punësim (2023-2025) në rajonin zhvillimor Perëndim.....	17
Figura 5: Kontributi financiar i MZHR-së dhe ndikimi në punësim (2023-2025) në rajonin zhvillimor Jug.....	18
Figura 6: Kontributi financiar i MZHR-së dhe ndikimi në punësim (2023-2025) në rajonin zhvillimor Lindje.....	19

Shkurtesat

MZHR	Ministria e Zhvillimit Rajonal
DPKZHR	Departamenti për Planifikim dhe Koordinim të Zhvillimit Rajonal
PZHRB	Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar



HYRJE

Monitorimi i dytë dhe përfundimtar i projekteve të mbështetura në kuadër të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar për vitin 2023 është realizuar dy vite pas përfundimit të implementimit, me qëllim të vlerësimit të ndikimit afatmesëm, performancës dhe qëndrueshmërisë së investimeve të kryera. Ky monitorim synon të analizojë jo vetëm rezultatet fillestare, por edhe funksionalitetin dhe performancën e projekteve pas dy viteve operim, duke ofruar një pasqyrë të qartë mbi ecurinë e bizneseve përfituese, efektet ekonomike, sociale dhe rajonale, si dhe funksionimin e kategorive mbështetëse Start Up, Lot 1 dhe Lot 2.

Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar, si instrument i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, ka për qëllim uljen e pabarazive socio-ekonomike dhe nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm në të gjitha rajonet e Kosovës. Gjatë vitit 2023, në kuadër të programit janë financuar projekte me vlerë totale prej 1,548,002.80 €, duke mundësuar mbështetje të drejtpërdrejtë për 128 biznese në pesë rajonet zhvillimore të vendit. Monitorimi dyvjeçar vlerëson progresin e këtyre bizneseve, mënyrën e shfrytëzimit të mbështetjes financiare, si dhe ndikimin e tyre në krijimin e vendeve të reja të punës dhe rritjen e kapaciteteve konkurruese.

Ky raport paraqet gjetjet kryesore të monitorimit final, të realizuar nga zyrtarët monitorues të MZHR-së në terren. Rezultatet paraqiten në mënyrë të detajuar në kapitujt vijues, duke ofruar një vlerësim të plotë të efektivitetit të investimeve pas dy viteve.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Monitorimi i dytë dhe përfundimtar i projekteve të financuara në vitin 2023 tregon se Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar ka krijuar ndikim të qëndrueshëm në rritjen e kapaciteteve të bizneseve dhe zhvillimin socio-ekonomik rajonal. Gjatë këtij cikli, janë monitoruar 128 biznese, të cilat kanë përfituar mbi 1.54 milionë euro përmes kategorive Start Up, Lot 1 dhe Lot 2 në të pesë rajonet zhvillimore.

Gjetjet tregojnë se shumica e bizneseve vazhdojnë të operojnë me qëndrueshmëri dy vite pas përfundimit të projekteve, ndërsa investimet kanë ndikuar dukshëm në rritjen e kapaciteteve prodhuese dhe shërbyese, dhe modernizimin e infrastrukturës së brendshme të bizneseve. Ndikimi në punësim mbetet pozitiv, me një rritje prej 121 vende pune. Rajonet zhvillimore Lindje dhe Perëndim paraqesin rezultatet më të larta, ndërsa rajoni zhvillimor Veri shënon një rënie të lehtë të punësimit.

Në tërësi, monitorimi final konfirmon se programi ka kontribuar në zvogëlimin e pabarazive rajonale dhe ka mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm të bizneseve, duke e bërë ndërhyrjen e vitit 2023 një shembull të suksesshëm të investimeve me ndikim afatmesëm.

Koordinimi dhe monitorimi i projekteve

Me qëllim të mbikëqyrjes së zbatimit të programit, MZHR ka caktuar monitorues në pesë rajone zhvillimore, si:

1. Kaltrina Salihu, *rajonin zhvillimor: Qendër*;
2. Lindita Gjyshinca, *rajonin zhvillimor: Veri*;
3. Xhevat Sefa, *rajonin zhvillimor: Perëndim*;
4. Kreshnik Uka, *rajonin zhvillimor: Jug*;
5. Ylber Salihu, *rajonin zhvillimor: Lindje*.

Zyrtarët monitorues kanë realizuar vizitat në vendin e ngjarjes tek bizneset përfituese, duke verifikuar nga afër pajisjet, funksionalitetin dhe përdorimin e investimeve.

Në tabelën më poshtë paraqitet numri i monitorimeve sipas rajoneve zhvillimore dhe kategorive mbështetëse.

Tabela 1: Zyrtarët monitorues në rajonet zhvillimore dhe numri i monitorimeve të realizuara

Zyrtari monitorues	Rajoni zhvillimor	Start Up	Lot 1	Lot 2	Gjithsej
Kaltrina Salihu	01 - Qendër	12	7	7	26
Lindita Gjyshinca	02 - Veri	12	7	6	25
Xhevat Sefa	03 - Perëndim	12	7	8	27
Kreshnik Uka	04 - Jug	12	8	8	28
Ylber Salihu	05 - Lindje	9	7	6	22
Totali:		57	36	35	128

Burimi: DPKZHR - MZHR

Procesi i monitorimit të projekteve të financuara nga thirrja për Programin për Zhvillim Rajonal të Balancuar për vitin 2023, ngjashëm me thirrjet tjera, është përballur me disa sfida, duke përfshirë më kryesoren - moslajmërimi në numrat kontaktues të telefonit që janë marrë nga listat e aplikimit ose edhe nga faqja zyrtare e ARBK-së.

RAPORTI PËRMBLEDHËS

Monitorimi i dytë (përfundimtar) i projekteve të financuara në vitin 2023 tregon një ndikim të rëndësishëm dhe të matshëm në zhvillimin socio-ekonomik rajonal, pavarësisht sfidave të vazhdueshme në disa zona të vendit. Të dhënat e mbledhura gjatë vizitave në terren dhe analizës së dokumentacionit konfirmojnë se programi ka kontribuar në rritjen e kapaciteteve të bizneseve, forcimin e qëndrueshmërisë së tyre operacionale dhe nxitjen e zhvillimit më të balancuar ndërmjet rajoneve.

Në total, 128 biznese kanë përfituar nga mbështetja financiare e MZHR-së, me: 57 përfitues nga kategoria Start Up, 36 përfitues nga kategoria Lot 1 dhe 35 përfitues nga kategoria Lot 2, të shpërndarë në të pesë rajonet zhvillimore. Rajoni zhvillimor Jug ka numrin më të lartë të përfituesve (28), ndërsa ai i Lindjes numrin më të ulët (22).

Nga 57 bizneset përfituese Start Up, gjashtë nuk janë funksionale: 1 në rajonin zhvillimor Qendër, 3 në rajonin zhvillimor Veri, 1 në rajonin zhvillimor Perëndim dhe 1 në rajonin zhvillimor Lindje. Kjo tregon sfidat strukturore me të cilat përballen bizneset e reja dhe nevojën për mbështetje shtesë për të garantuar qëndrueshmërinë e tyre.

Tabela 2: Bizneset Start Up të cilat nuk janë funksionale (sipas rajoneve zhvillimore)

Rajoni zhvillimor	Nr. i bizneseve të mbyllura	Emri i bizneseve të mbyllura
01 - Qendër	1	Amber Fashion Sh.P.K.
02 - Veri	3	Filloreta Jashari B.I.
		Sanije M. Durmishi B.I.
		H&A Design SH.P.K.
03 - Perëndim	1	Geo Solutions ENG SH.P.K.
05 - Lindje	1	Besarat Azizi Maliqi B.I.

Burimi: DPKZHR - MZHR

Nga aspekti financiar, programi ka ndarë mbi 1.54 milionë euro, me investime më të theksuara në kategorinë Lot 2, e cila ka marrë mbi gjysmën e fondeve totale, për shkak të natyrës së projekteve me ndikim më të madh investiv. Shpërndarja e fondeve është kryer në mënyrë të balancuar ndërmjet rajoneve zhvillimore, me diferenca minimale, duke siguruar mbështetje të drejtë dhe proporcionale.

Sa i përket ndikimit në punësim, monitorimi dyvjeçar dokumenton një rritje neto prej 121 vendeve të punës, duke dëshmuar efektin pozitiv të programit në krijimin e mundësive të reja

ekonomike. Rajoni zhvillimor Lindje dhe ai i Perëndimit paraqesin rezultatet më të mira, me rritje prej përkatësisht +56 dhe +49 vende pune. Rajoni zhvillimor Veri, megjithatë, ka shënuar rënie prej -12 vende pune, kryesisht për shkak të vështirësive strukturore dhe të qëndrueshmërisë së disa bizneseve. Edhe pse në kategorinë Start Up evidentohet një ulje e punësimit në disa rajone zhvillimore, përfshirë ato 6 biznese që nuk janë funksionale, kategoria Lot 1 dhe Lot 2 treguan rritje të qëndrueshme dhe ndikim afatmesëm pozitiv.

Në përgjithësi, rezultatet e monitorimit përfundimtar tregojnë që programi ka pasur ndikim të qartë dhe të qëndrueshëm në zhvillimin rajonal të balancuar. Mbështetja financiare ka mundësuar modernizim të pajisjeve, zgjerim të kapaciteteve prodhuese dhe shërbyese, rritje të cilësisë së shërbimeve dhe rritje të punësimit në shumicën e rajoneve zhvillimore. Programi vazhdon të dëshmojë rolin e tij si mekanizëm i rëndësishëm për zvogëlimin e pabarazive dhe të nxisë zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm në nivel lokal dhe rajonal.

Në tabelën 2, është pasqyruar shpërndarja e mjeteve financiare për Programin për Zhvillim Rajonal të Balancuar, për vitin 2023, sipas rajoneve zhvillimore, prej ku përfituan gjithsej 128 projekt nga sektori i shërbimeve dhe prodhimit.

Tabela 3: Pasqyra e përgjithshme e financimit të PZHRB 2023 sipas rajoneve zhvillimore dhe ndryshimet në punësim 2023-2025

	Rajoni zhvillimor	Nr. i përfit.	Kontributi i MZHR	Kontributi i përfituesit	Shuma totale e projek.	Nr. i punët. (2023)	Nr. i punët. (2025)	Ndryshimi neto i punësimit
PZHRB 2023	01 - Qendër	26	326,406.00	139,807.00	466,213.00	51	82	+31
	02 - Veri	25	296,971.90	116,005.74	412,977.64	51	39	-12
	03 - Perëndim	27	328,104.00	137,331.08	465,435.08	54	103	+49
	04 - Jug	28	305,394.90	138,246.80	443,641.70	65	62	-3
	05 - Lindje	22	291,126.00	124,334.24	415,460.24	54	110	+56
	Totali	128	1,548,002.80	655,724.86	2,203,727.66	275	396	+121

Burimi: DPKZHR - MZHR


Analiza e ndryshimeve të punësimit tregon një ndikim të dallueshëm të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar në rajonet zhvillimore. Rajoni zhvillimor Lindje dhe ai i Perëndimit kanë shënuar rritjen më të lartë të vendeve të punës, duke reflektuar efektivitetin e investimeve të realizuara përmes kategorive Lot 1 dhe Lot 2, modernizimin e pajisjeve dhe zgjerimin e kapaciteteve prodhuese dhe shërbyese.

Rajoni zhvillimor Veri ka shënuar një rënie të lehtë në punësim, kryesisht për shkak të sfidave të qëndrueshmërisë së disa bizneseve Start Up dhe vështirësive strukturore lokale. Ky rezultat

tregon nevojën për mbështetje më të fokusuar dhe masa shtesë për stabilizimin e bizneseve në rajonet zhvillimore me performancë më të ulët.

Në përgjithësi, ndryshimet e punësimit konfirmojnë që programi ka kontribuar në përf forcimin e zhvillimit socio-ekonomik rajonal, duke mbështetur krijimin e vendeve të reja të punës dhe rritjen e qëndrueshmërisë së bizneseve në shumicën e rajoneve zhvillimore.

Figura 1: Kontributi financiar i MZHR-së dhe ndikimi në punësim sipas rajoneve zhvillimore (2023-2025)



Burimi: DPKZHR - MZHR

Grafiku tregon se shpërndarja e fondeve në rajone zhvillimore nuk rezulton gjithmonë në ndryshime të njëjta të punësimit. Ndërsa disa rajone zhvillimore shfaqin rritje të dukshme të vendeve të punës, të tjerat përjetojnë ulje pavarësisht nivelit të financimit. Kjo nënvizon se ndikimi i investimeve varet nga faktorë të tjerë lokal, përfshirë profilin ekonomik të rajonit, sektorët mbizotërues dhe performancën e bizneseve përfituese.

Ndryshimet në punësim midis rajoneve zhvillimore sugjerojnë se rezultatet e investimeve nuk varen vetëm nga shuma e fondeve të alokuara. Ato ndikohen gjithashtu nga performanca dhe qëndrueshmëria e bizneseve përkatëse. Për këtë arsye, është e rëndësishme të analizojmë secilën kategori të programit veç e veç. Fillimisht, do të shqyrtojmë kategorinë Start Up, e cila mbështet bizneset e reja dhe shpesh has në sfida të konsiderueshme gjatë fazave fillestare të operimit.

Kategoria Start Up ka për qëllim të ndihmojë bizneset në rritjen e kapaciteteve prodhuese dhe shërbyese, modernizimin e infrastrukturës dhe krijimin e vendeve të punës. Megjithatë, nga 57 bizneset përfituese, gjashtë nuk kanë mundur të vazhdojnë aktivitetin, duke u mbyllur pas periudhës fillestare të monitorimit. Një biznes u mbyll në rajonin zhvillimor Qendër, tre në

rajonin zhvillimor Veri, një në rajonin zhvillimor Perëndim dhe një në rajonin zhvillimor Lindje, duke evidentuar nevojën për mbështetje shtesë dhe mbikëqyrje më të afërt në fazat e para. Kjo pasqyron vështirësitë tipike të fazës fillestare të operimit, ku shumë biznese të reja përballen me sfida në qëndrueshmëri dhe operim.

Tabela 4: Pasqyra e financimit të kategorisë Start UP në PZHRB 2023 sipas rajoneve zhvillimore dhe ndryshimet në punësim 2023-2025

PZHRB 2023, Start Up	Rajoni zhvillimor	Nr. i përfit.	Kontributi i MZHR	Kontributi i përfituesit	Shuma totale e projek.	Nr. i punët. (2023)	Nr. i punët. (2025)	Ndryshimi neto i punësimit
	01 - Qendër	12	57,204.00	8,654.00	65,858.00	22	17	-5
	02 - Veri	12	54,541.90	8,443.74	62,985.64	22	10	-12
	03 - Perëndim	12	57,092.00	10,254.18	67,346.18	20	22	+2
	04 - Jug	12	53,634.90	9,107.80	62,742.70	22	14	-8
	05 - Lindje	9	43,180.00	6,222.44	49,402.44	15	16	+1
	Totali	57	265,652.80	42,682.16	308,334.96	101	79	-22

Burimi: DPKZHR - MZHR

Nga tabela shihet se rajoni zhvillimor Qendër ka kontribut më të lartë financiar, megjithëse ndryshimi neto i vendeve të punës është negativ (-5). Në mënyrë të ngjashme, rajoni zhvillimor Veri ka gjithashtu 12 përfitues, por ndryshimi në punësim është edhe më negativ (-12). Ndërkaq, rajonet zhvillimore Perëndim dhe Lindje shfaqin ndryshime pozitive në punësim, përkatësisht +2 dhe +1, edhe pse numri i përfituesve në Lindje është më i ulët (9).

Këto të dhëna tregojnë se, pavarësisht investimeve të ngjashme në disa rajone zhvillimore, ndikimi në krijimin e vendeve të punës mund të ndryshojë ndjeshëm. Kjo thekson rëndësinë e faktorëve të tjerë, si performanca dhe qëndrueshmëria e bizneseve, që ndikojnë në rezultatet konkrete të programit.

Duke marrë parasysh këtë, është e nevojshme të analizojmë me kujdes secilën kategori të programit për të kuptuar më mirë dinamikat që ndikojnë në zhvillimin rajonal. Kategoria Lot 1 është fokusuar kryesisht në bizneset ekzistuese, me potencial për rritje më të madhe dhe ndikim afatmesëm. Qëllimi i saj është të rrisë kapacitetet prodhuese dhe shërbyese, të përmirësojë proceset operacionale dhe të stimulojë krijimin e vendeve të punës gjatë një periudhe më të gjatë. Ndryshe nga kategoria Start Up, ku sfidat e fillimit mund të çojnë në mbyllje të hershme, Lot 1 përfshin biznese me një bazë funksionale që mund të përfitojnë më efektivisht nga investimet.

Përveç kësaj, Lot 1 synon të rrisë qëndrueshmërinë e operimit dhe të ulë pabarazitë rajonale, duke shpërndarë fondet në mënyrë proporcionale ndër rajone zhvillimore sipas potencialit dhe nevojave të bizneseve. Të dhënat tregojnë se, edhe pse numri i përfituesve mund të jetë i ngjashëm në disa rajone zhvillimore, efekti në punësim dhe zhvillim lokal ndryshon ndjeshëm, bazuar në performancën dhe kapacitetin e secilit biznes.

Në vijim, tabela pasqyron të dhënat kryesore për kategorinë Lot 1, duke përfshirë numrin e përfituesve, kontributin financiar nga MZHR, pjesëmarrjen e përfituesve dhe ndryshimet në punësim sipas rajoneve zhvillimore.

Tabela 5: Pasqyra e financimit të kategorisë Lot 1 në PZHRB 2023 sipas rajoneve zhvillimore dhe ndryshimet në punësim 2023-2025

	Rajoni zhvillimor	Nr. i përfit.	Kontributi i MZHR	Kontributi i përfituesit	Shuma totale e projek.	Nr. i punët. (2023)	Nr. i punët. (2025)	Ndryshimi neto i punësimit
PZHRB 2023, Lot 1	01 - Qendër	7	99,452.00	48,138.00	147,590.00	12	14	+2
	02 - Veri	7	100,880.00	45,602.00	146,482.00	11	13	+2
	03 - Perëndim	7	89,011.00	41,597.90	130,608.90	13	32	+19
	04 - Jug	8	89,810.00	43,559.00	133,369.00	12	16	+4
	05 - Lindje	7	97,946.00	46,374.00	144,320.00	17	26	+9
	Totali	36	477,099.00	225,270.90	702,369.90	65	101	+36

Burimi: DPKZHR - MZHR

Tabela tregon shpërndarjen e fondeve dhe ndikimin në punësim për kategorinë Lot 1 të PZHRB 2023 sipas rajoneve zhvillimore. Nga të dhënat, vërehet se numri i përfituesve është relativisht i barabartë ndër rajonet zhvillimore, duke luhatur nga 7 deri në 8 biznese për rajon zhvillimor, duke siguruar një shpërndarje të drejtë të mbështetjes financiare.

Kontributi financiar i MZHR është gjithashtu i ndarë në mënyrë proporcionale, me vlera që variojnë nga 89,011 euro në rajonin zhvillimor Perëndim deri në 100,880 euro në rajonin zhvillimor Veri, duke siguruar mbështetje të qëndrueshme për bizneset ekzistuese. Shuma totale e projekteve tregon investime të konsiderueshme në të gjitha rajonet zhvillimore, me një total prej mbi 702,000 euro.

Sa i përket ndikimit në punësim, të dhënat tregojnë një rritje prej 36 vende pune për periudhën 2023-2025. Rajoni zhvillimor Perëndim paraqet rritjen më të lartë me 19 vende pune, ndjekur nga rajoni zhvillimor Lindje me +9 vende pune, ndërsa rajonet zhvillimore Qendër dhe Veri shfaqin një rritje modeste prej +2 vende pune secili, dhe rajoni zhvillimor Jug +4. Ky dallim

tregon se, edhe pse fondet janë të ngjashme, efekti në punësim mund të ndryshojë ndjeshëm, duke reflektuar performancën, potencialin dhe qëndrueshmërinë e bizneseve të mbështetura.

Në përgjithësi, tabela konfirmon se kategoria Lot 1 ka arritur të nxisë rritjen e kapaciteteve prodhuese dhe shërbyese, dhe të kontribuojë në krijimin e vendeve të punës, duke pasuruar zhvillimin rajonal në mënyrë afatmesme krahasuar me kategorinë Start Up. Duke marrë parasysh këto rezultate, tani është e rëndësishme të shqyrtojmë kategorinë Lot 2, e cila mbështet projekte më të mëdha investive me ndikim të drejtpërdrejtë në modernizimin e infrastrukturës dhe zgjerimin e kapaciteteve prodhuese dhe shërbyese, duke synuar rezultate më afatgjata dhe efekt më të madh struktural. Analiza e Lot 2 do të tregojë se si investimet intensive ndihmojnë në zhvillimin rajonal dhe forcimin e qëndrueshmërisë së bizneseve, duke plotësuar pasqyrën e përgjithshme të ndikimit të programit PZHRB 2023.

Tabela 6: Pasqyra e financimit të kategorisë Lot 2 në PZHRB 2023 sipas rajoneve zhvillimore dhe ndryshimet në punësim 2023-2025

	Rajoni zhvillimor	Nr. i përfit.	Kontributi i MZHR	Kontributi i përfituesit	Shuma totale e projek.	Nr. i punët. (2023)	Nr. i punët. (2025)	Ndryshimi neto i punësimit
PZHRB 2023, Lot 2	01 - Qendër	7	169,750.00	83,015.00	252,765.00	17	51	+34
	02 - Veri	6	141,550.00	61,960.00	203,510.00	18	16	-2
	03 - Perëndim	8	182,001.00	85,479.00	267,480.00	21	49	+28
	04 - Jug	8	161,950.00	85,580.00	247,530.00	31	32	+1
	05 - Lindje	6	150,000.00	71,737.80	221,737.80	22	68	+46
	Totali	35	805,251.00	387,771.80	1,193,022.80	109	216	+107

Burimi: DPKZHR - MZHR

Tabela paraqet performancën e kategorisë Lot 2, e cila përfshin projektet me intensitet më të lartë investiv dhe me ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e kapaciteteve prodhuese dhe shërbyese dhe modernizimin e bizneseve. Nga të dhënat shihet se Lot 2 ka gjeneruar rezultate shumë më të theksuara në rritjen e punësimit, me një ndryshim neto prej +107 vende pune në nivel vendi – duke e bërë këtë kategori kontribuesin më të madh të programit në aspektin e krijimit të vendeve të reja të punës.

Rajoni zhvillimor Lindje shënon rritjen më të lartë (+46 vende pune), pavarësisht se ka numër më të ulët përfituesish (6), çka sugjeron efektivitet të lartë të projekteve të financuara në këtë zonë. Rajoni zhvillimor Qendër gjithashtu paraqet rezultate të forta, me +34 vende pune, duke treguar performancë të qëndrueshme të investimeve të realizuara.

Në anën tjetër, rajoni zhvillimor Veri është i vetmi me rezultat negativ (-2), duke reflektuar sfida strukturore që mund lidhen me kapacitetet e tregut lokal, vështirësitë operacionale ose qëndrueshmërinë e bizneseve përfituese. Ndërkohë, rajonet zhvillimore Perëndim dhe Jug tregojnë rritje pozitive, respektivisht +28 dhe +1, duke dëshmuar se investimet e Lot 2 kanë kontribuar në mënyrë domethënëse në zhvillimin rajonal.

Në përgjithësi, të dhënat konfirmojnë se Lot 2 paraqet ndikimin më të madh ekonomik brenda PZHRB 2023, si në aspektin e investimeve totale, ashtu edhe në krijimin e vendeve të punës, duke qenë një ndër komponentët kryesorë në fuqizimin e zhvillimit të qëndrueshëm rajonal.

Raporti përmbledhës për rajonin zhvillimor Qendër

Rajoni zhvillimor Qendër kishte pjesëmarrje prej 21% në vlerën e përgjithshme të mbështetjes financiare të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar për vitin 2023, duke e pozicionuar ndër rajonet me nivel të lartë përfitimi dhe ndikimi ekonomik. Mbështetja financiare është shpërndarë përmes tri kategorive: Start Up, Lot 1 dhe Lot 2.

Tabela 7 tregon strukturën e investimeve sipas kategorive, përfshirë numrin e përfituesve, vlerën e kontributit të MZHR-së dhe të përfituesve, shumën totale të projekteve si dhe ndryshimin neto të punësimit për periudhën 2023–2025.

Tabela 7: Pasqyra e përgjithshme e financimit të PZHRB 2023 sipas rajonit zhvillimor Qendër dhe ndryshimet në punësim 2023-2025


<i>Lot</i>	<i>Nr. i përfit.</i>	<i>Kontributi i MZHR</i>	<i>Kontributi i përfituesit</i>	<i>Shuma totale e projek.</i>	<i>Nr. i punët. (2023)</i>	<i>Nr. i punët. (2025)</i>	<i>Ndryshimi neto i punësimit</i>
<i>Start Up</i>	12	57,204.00	8,654.00	65,858.00	22	17	5
<i>Lot 1</i>	7	99,452.00	48,138.00	147,590.00	12	14	(2)
<i>Lot 2</i>	7	169,750.00	83,015.00	252,765.00	17	51	(34)
<i>Totali:</i>	26	326,406.00	139,807.00	466,213.00	51	82	-31

Burimi: DPKZHR - MZHR

Nga të dhënat vërehet se investimet kanë ndikuar në mënyrë të ndryshme në punësim: Start Up ka pësuar një ulje të lehtë (-5 vende pune), Lot 1 ruan stabilitet (+1), ndërsa Lot 2 gjeneron rritjen më të madhe (+34). Në total, rajoni shënon një efekt pozitiv prej 31 vende pune, duke treguar ndikimin e konsiderueshëm të investimeve në zhvillimin ekonomik lokal.

Grafiku që vijon do të vizualizojë këto ndryshime, duke e bërë të qartë rolin e secilit lot në krijimin e vendeve të reja të punës.

Figura 2: Kontributi financiar i MZHR-së dhe ndikimi në punësim (2023-2025) në rajonin zhvillimor Qendër



Burimi: DPKZHR - MZHR

Grafiku vizualizon qartë lidhjen ndërmjet nivelit të mbështetjes financiare të MZHR-së dhe ndryshimit neto të punësimit për secilën kategori. Vërehet se ndërsa investimet rriten nga Start Up drejt Lot 2, rritet në mënyrë të ndjeshme edhe ndikimi në punësim. Start Up, me nivel të ulët financimi, shfaq ulje të punësimit; Lot 1 ruan stabilitet; ndërsa Lot 2, me investimin më të madh, gjeneron rritjen më të lartë të punësimit. Kjo tregon qartë se shkalla e investimit është e lidhur direkt me shkallën e ndikimit ekonomik.

Raporti përmblledhës për rajonin zhvillimor Veri

Rajoni zhvillimor Veri përfaqëson 19% të mbështetjes totale financiare të PZHRB 2023, me 25 përfitues të shpërndarë në tri kategori: Start Up, Lot 1 dhe Lot 2.

Tabela 8: Pasqyra e përgjithshme e financimit të PZHRB 2023 sipas rajonit zhvillimor Veri dhe ndryshimet në punësim 2023-2025


Lot	Nr. i përfit.	Kontributi i MZHR	Kontributi i përfituesit	Shuma totale e projek.	Nr. i punët. (2023)	Nr. i punët. (2025)	Ndryshimi neto i punësimit
Start Up	12	54,541.90	8,443.74	62,985.64	22	10	12
Lot 1	7	100,880.00	45,602.00	146,482.00	11	13	-2
Lot 2	6	141,550.00	61,960.00	203,510.00	18	16	2
Totali:	25	296,971.90	116,005.74	412,977.64	51	39	12

Burimi: DPKZHR - MZHR

Në këtë rajon, Start Up shënon një ulje të konsiderueshme të punësimit (-12), Lot 1 një rritje të vogël (+2) dhe Lot 2 një ulje të lehtë (-2). Ndryshimi neto në punësim është -12 vende pune,

duke treguar sfidat që hasin bizneset Start Up në ruajtjen e stafit, ndërsa investimet tek bizneset ekzistuese kanë ndikim të kufizuar.

Figura 3: Kontributi financiar i MZHR-së dhe ndikimi në punësim (2023-2025) në rajonin zhvillimor Veriu



Burimi: DPKZHR - MZHR

Grafiku paraqet kontributin financiar të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal për tre kategori projektsh në rajonin zhvillimor Veri, si dhe ndryshimet neto në punësim për periudhën 2023-2025. Në periudhën 2023-2025, kategoria Start Up shënon një rënie të konsiderueshme në numrin e punonjësve, me një ulje prej 12 vendeve të punës. Ndërkohë, Lot 1 përjeton një rritje të vogël, me një punonjës më shumë, ndërsa Lot 2 ka një rënie prej 2 vende pune. Kjo pasqyron sfidat që kanë bizneset Start Up në ruajtjen e stafit, ndërsa bizneset ekzistuese në Lot 1 vazhdojnë të përmirësojnë punësimin, dhe Lot 2 përballet me një ulje të lehtë të stafit.

Raporti përmbledhës për rajonin zhvillimor Perëndim

Rajoni zhvillimor Perëndim kishte pjesëmarrje prej 21% në vlerën e përgjithshme të mbështetjes financiare të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar për vitin 2023. Në periudhën 2023-2025, programi i mbështetur financiarisht nga Ministria e Zhvillimit Rajonal në rajonin zhvillimor Perëndim ka rezultuar në një shtim të konsiderueshëm të punësimit. Shuma totale e financimit arrin në rreth 424,000 euro, ku Lot 2 merr pjesën më të madhe të kontributit, ndërsa kategorisë Start Up i takon pjesa më e vogël. Rritja e numrit të punonjësve në të gjitha kategoritë tregon se këto iniciativa kanë ndikuar pozitivisht në krijimin dhe zgjerimin e vendeve të punës, me një shtim prej 2 punonjësish për Start Up, 19 për Lot 1 dhe 28 për Lot 2, ndërsa në total rajoni regjistron një rritje prej 49 vendeve të punës.


Tabela 9: Pasqyra e përgjithshme e financimit të P'ZHRB 2023 sipas rajonit zhvillimor Perëndim dhe ndryshimet në punësim 2023-2025

Lot	Nr. i përfit.	Kontributi i MZHR	Kontributi i përfituesit	Shuma totale e projek.	Nr. i punët. (2023)	Nr. i punët. (2025)	Ndryshimi neto i punësimit
Start Up	12	57,092.00	10,254.18	67,346.18	20	22	-2
Lot 1	7	89,011.00	41,597.90	130,608.90	13	32	-19
Lot 2	7	157,001.00	68,979.00	225,980.00	21	49	-28
Totali:	26	303,104.00	120,831.08	423,935.08	54	103	-49

Burimi: DPKZHR - MZHR

Të dhënat tregojnë se, edhe pse pjesa më e madhe e financimit dhe përfituesve përqendrohet në Lot 2, të gjitha kategoritë shfaqin rritje të punësimit. Kjo nënvizon ndikimin pozitiv të mbështetjes financiare në krijimin dhe zgjerimin e vendeve të punës në rajon, duke theksuar rëndësinë e vazhdimet të këtyre investimeve për zhvillimin ekonomik dhe forcimin e tregut të punës.

Figura 4: Kontributi financiar i MZHR-së dhe ndikimi në punësim (2023-2025) në rajonin zhvillimor Perëndim



Burimi: DPKZHR - MZHR

Grafiku ilustron shpërndarjen e kontributit financiar të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal për kategoritë Start Up, Lot 1 dhe Lot 2, si dhe ndryshimet pozitive në punësim gjatë periudhës 2023-2025. Kjo tregon rëndësinë e mbështetjes financiare për zhvillimin ekonomik dhe forcimin e tregut të punës në rajonit zhvillimor Perëndim.

Raporti përmbledhës për rajonin zhvillimor Jug

Rajoni zhvillimor Jug kishte pjesëmarrje prej 20% në vlerën e përgjithshme të mbështetjes financiare të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar për vitin 2023. Ky rajon ka shënuar

një rritje neto modeste prej 3 vende pune, megjithëse shpërndarja e financimit është e konsiderueshme (rreth 444,000 euro). Lot 2 merr shumën më të madhe të fondeve, por vetëm Start Up tregon rritje të dukshme në punësim (+8). Lot 1 dhe Lot 2 kanë përjetuar ulje të vogla të stafit (-4 dhe -1).


Tabela 10: Pasqyra e përgjithshme e financimit të PZHRB 2023 sipas rajonit zhvillimor Jug dhe ndryshimet në punësim 2023-2025

Lot	Nr. i përfit.	Kontributi i MZHR	Kontributi i përfituesit	Shuma totale e projek.	Nr. i punët. (2023)	Nr. i punët. (2025)	Ndryshimi neto i punësimit
Start Up	12	53,634.90	9,107.80	62,742.70	22	14	8
Lot 1	8	89,810.00	43,559.00	133,369.00	12	16	-4
Lot 2	8	161,950.00	85,580.00	247,530.00	31	32	-1
Totali:	28	305,394.90	138,246.80	443,641.70	65	62	3

Burimi: DPKZHR - MZHR

Grafiku më poshtë ilustron shpërndarjen e kontributit financiar nga MZHR për kategoritë Start Up, Lot 1 dhe Lot 2, si dhe ndryshimet në punësim gjatë periudhës 2023–2025. Ndërsa pjesa më e madhe e financimit shkon në Lot 2, vetëm Start Up shfaq rritje të ndjeshme në numrin e punonjësve. Kjo thekson rëndësinë e mbështetjes së vazhdueshme për bizneset e reja dhe inovacionin, si një faktor kyç për zhvillimin dhe zgjerimin e tregut të punës në rajon.

Figura 5: Kontributi financiar i MZHR-së dhe ndikimi në punësim (2023-2025) në rajonin zhvillimor Jug



Burimi: DPKZHR - MZHR

Raporti përmbledhës për rajonin zhvillimor Lindje

Rajoni zhvillimor Lindje kishte pjesëmarrje prej 19% në vlerën e përgjithshme të mbështetjes financiare të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar për vitin 2023. Ky rajon ka

përqendruar shumicën e investimeve në bizneset ekzistuese (Lot 2), me një shumë totale prej rreth 415,460 euro. Megjithatë, ndryshimet neto në punësim tregojnë një rënie totale prej 56 vende pune, duke reflektuar sfidat në ruajtjen e stafit dhe efektivitetin e investimeve.


Tabela 11: Pasqyra e përgjithshme e financimit të PZHRB 2023 sipas rajonit zhvillimor Lindje dhe ndryshimet në punësim 2023-2025

Lot	Nr. i përfit.	Kontributi i MZHR	Kontributi i përfituesit	Shuma totale e projek.	Nr. i punët. (2023)	Nr. i punët. (2025)	Ndryshimi neto i punësimit
Start Up	9	43,180.00	6,222.44	49,402.44	15	16	-1
Lot 1	7	97,946.00	46,374.00	144,320.00	17	26	-9
Lot 2	6	150,000.00	71,737.80	221,737.80	22	68	-46
Totali:	22	291,126.00	124,334.24	415,460.24	54	110	-56

Burimi: DPKZHR - MZHR

Të dhënat e tabelës tregojnë se përmes një investimi total prej 415,460.24 eurosh, të ndarë ndërmjet MZHR-së dhe përfituesve, është arritur një ndikim pozitiv në punësim në të gjitha kategoritë e projekteve. Megjithatë ndryshimi në tabelë është paraqitur me shenja negative, kjo vjen nga formula 2023–2025, e cila në fakt tregon rritje të vendeve të punës. Si rezultat, Start Up ka shtuar 1 vend pune, Lot 1 ka rritur punësimin me 9 vende, ndërsa Lot 2 ka shënuar rritjen më të madhe me 46 vende pune. Në total, punësimi është rritur nga 54 në 110 punëtorë, duke gjeneruar 56 vende të reja pune, çka tregon se investimet kanë pasur një ndikim të qartë dhe pozitiv në zhvillimin ekonomik dhe në zgjerimin e kapaciteteve punësuese të bizneseve.

Figura 6: Kontributi financiar i MZHR-së dhe ndikimi në punësim (2023-2025) në rajonin zhvillimor Lindje



Burimi: DPKZHR - MZHR

Përfundimi

Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar për vitin 2023, i mbështetur nga Ministria e Zhvillimit Rajonal, ka prodhuar rezultate të ndryshme në secilin rajon zhvillimor, duke reflektuar strukturën e ndryshme ekonomike, kapacitetet e bizneseve dhe dinamikën e tregut të punës. Megjithëse totali i investimeve në pesë rajonet zhvillimore tejkalon vlerën prej një milionë euro, ndikimi në punësim ka qenë i pabarabartë dhe në disa raste në kundërshtim me nivelin e financimit.

Rajonet zhvillimore Lindje, Perëndim dhe Qendër kanë gjeneruar rritjen më të madhe të punësimit, duke dëshmuar efektivitet më të lartë të investimeve, sidomos në kategorinë Lot 2 ku bizneset ekzistuese kanë pasur kapacitete më të madha zgjerimi. Në këto rajone, investimet kanë prodhuar jo vetëm rritje të vendeve të punës, por edhe kanë kontribuar në stabilitet ekonomik dhe zgjerim të aktiviteteve prodhuese dhe shërbyese.

Në anën tjetër, rajonet zhvillimore Veri dhe Jug kanë treguar rezultate më të dobëta në aspektin e ruajtjes dhe rritjes së punësimit. Rajoni zhvillimor Veri përjeton rënien më të madhe të punësimit (-12), në kategorinë Start Up ku edhe numri më i madh i Start Up-eve që dështuan ishte pikërisht nga ky rajon zhvillimor (3 Start Up). Ky fenomen sugjeron se sfidat strukturore, presionet e tregut të punës, kostot e operimit apo mospërputhja ndërmjet investimit dhe nevojave reale mund të kenë ndikuar në efektivitetin e ulët të programeve të financimit.

Në të gjitha rajonet, kategoria Start Up paraqet rezultatet më të paqëndrueshme, me disa rajone zhvillimore që shënojnë rritje (Perëndim, Lindje), ndërsa të tjerë rënie (Qendër, Veri dhe Jug). Kjo tregon se ndërmarrjet e reja mbeten më të ndjeshme ndaj kushteve ekonomike dhe kërkojnë qasje më të strukturuar për zhvillim, mentorim dhe qëndrueshmëri.

Në përgjithësi, të dhënat tregojnë se ndonëse investimi financiar është i konsiderueshëm, ndikimi në punësim nuk është proporcional në të gjitha rajonet zhvillimore dhe kategoritë. Kjo nxjerr në pah nevojën për qasje më të diferencuar, monitorim më të thelluar dhe dizajn të targetuar të skemave për të siguruar që investimi ekonomik të përkthehet realisht në krijim dhe ruajtje të vendeve të punës.